



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:138664
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05772168

C.nr.184/20

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.A. dhe G.A., nga Komuna e Skenderajt, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,990.00 Euro, jashtë seance, me datë **03.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër C.nr.184/20, i paditësve M.A. dhe G.A., nga Skenderaj, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kompensim dëmi.

A r s y e t i m

Paditëset kanë ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 14.04.2020, kundër të paditurës për kompensim dëmi.

Me parashtresën e datës 16.05.2024, i autorizuari i paditësve e ka njoftuar gjykatën se e bënë tërheqjen e padisë, pasi me të paditurën kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Numri i lëndës: 2020:138664
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05772168

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.184/20, të datës 03.06.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.